



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politik dhe Financa

01Nr 60-20705/2019

Klinë, me 27.05/2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IV-te Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 17.04.2019, me fillim nga ora 10:00, në sallën e Kuvendit Komunal

Mbledhjen e Komitetit e hapi kryesuesi z. Fadil Gashi, i cili fillimisht përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa, ndërsa Xhevxhet Berisha i cili mungon në këtë fillim të seancës pritet që të vij së shpejti. Kryesuesi Gashi, në vazhdim prezantoi Rendin e Ditës.

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Komunës për periudhën janar-mars 2019 (ref. drejtori i FEZH),
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë së fëmijëve në Komunën e Klinës,
5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë për vitin 2019,
6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politik dhe Financa të arritura për muajin mars-prill 2019,
7. Të ndryshme,

Kryesuesi Fadil Gashi, hapi debat rreth rëndit të ditës, theksoj se mungon materiali i Planit të Veprimit për Transparencë, është një plan unik s'mund ta ndryshojmë strukturën e tij, por vetëm

se duhet të bëhet për katër vite, kemi edhe një kërkesë nga Drejtoria e Financave për transfer të mjeteve nga kategoria e pagave kërkohej për harmonizimin e mjeteve të pagave ndërmjet nën programeve në kuadër të organizatës arsim Shkencë,

Me 6 vota PËR u miratua rendi i ditës.

Pjesëmarrës në mbledhje ishin anëtarët e Komitetit:

- 1.Fadil Gashi-kryesues
- 2.Enver Berisha-anëtar
3. Mendehe Duraku-anëtare
4. Tunë Dedaj-anëtar
5. Blerta Gashi-anëtare
6. Violeta Zefi-anëtare

Ndërsa, pjesëmarrës tjerë ishin: OJQ"ZANA", përfaqësues nga OSBE, drejtori Aziz Desku, drejtori Lorenc Marleku.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Të gjithë anëtarët ishin prezent, në sall erdhi edhe Xhevdet Berisha,

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debat, nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit urdhëroni,

Pasi që askush nuk mori fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, Kryesuesi vuri në votim, dhe me 7 vota PËR u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës për periudhën janar-mars 2019.

Kryesuesi Fadil Gashi, tha se drejtori i Drejtorisë qenka prezent në mbledhje ju kisha lutur që të na prezantojë dhe pastaj do të hapim debat rreth kësaj pike, urdhëroni drejtor Aziz Desku.

Z. Aziz Desku, përshëndeti të gjithë të pranishmit, tha duke krahasuar buxhetin e vitit të kaluar 2018 me vitin 2019, buxheti për këtë vit është 3.91% më i madh duke mos përfshirë një pjesë të hyrave në arsim dhe shëndetësi, të cilat nuk janë alokuar, sa i përket shpenzimeve të realizuara në këtë 3 muaj, dhe duke krahasuar me shpenzimet e 3 muajorit të njëjtë të vitit të kaluar përafërsisht janë të njëjta, ka vetëm 0.89% ndryshim në raport me vitin 2018, shpenzime të përgjithshme këtë vit janë 1.771.415.54, ndërsa në vitin 2018 në periudhën e njëjtë kanë qenë 1.755.723.88.

Sa i përket shpenzimeve nëpër kategoritë ekonomike, shpenzime për paga krahasuar me buxhetin përbëjnë 24.42 % të buxhetit d.m.th $\frac{1}{4}$ e buxhetit, tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve 18.99%, të shërbimet komunale 17.41%, të subvencionet 3.01%, dhe tek ato kapitale 2.88%, sa i përket shpenzimeve nëpër kategori të caktuar, dhe kur bëjmë një krahasim me buxhetin e këtij viti mund të vëreni se vetëm se tek një numër i vogël kemi tejkalime, ndërsa pjesa më e madhe e shpenzime janë nën këtë 25% të këtij 3 mujori të parë, rritje kemi tek shpenzimet për internet, te shpenzimet për anëtarësim, ku bëhet fjalë për anëtarësim në Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe në Agjencionin e Zhvillimit Rajonal në Pejë, Komuna ka kryer të gjitha pagesat komplet që i ka detyrim Komuna, për këtë arsye edhe kemi rritje, por gjatë periudhave vijuese nuk do të ketë më shpenzime. Kemi rritje tek kategoria e kompjuterëve, bëhet fjalë për kontratën e vitit të kaluar, e cila është realizuar gjatë këtij viti, bëhet fjalë për laptopët e anëtarëve të Kuvendit dhe për kompjuterët e drejtorive komunale, dhe kjo ka bërë që shpenzimet të jenë më të mëdha, mandej furnizimet mjekësore janë të planifikuara në raport me buxhetin, ka pak rritje të shpenzimeve tek mirëmbajtja e pajisjeve, mobiliet dhe konkurset, ndërsa të gjitha shpenzimet tjera janë nën planifikimin buxhetorë për tremujorin e parë të këtij viti, duke e krahasuar këtë tremujorë me tremujorin e vitit të kaluar. Rritje të shpenzimeve kemi tek kategoria e shpenzimeve të telefonit, tek ato kontraktuese, shpenzimet për mobileje, shpenzime për kompjuterë, shpenzime për pajisje tjera, furnizime për ushqime jo dreka, shpenzime për dru, shpenzime për karburante për vetura, shpenzime tek mirëmbajtjen e shkollave dhe vendimet e gjykatave, ndërsa të gjitha shpenzimet tjera kanë ulje në krahasim me vitin e kaluar në periudhën e njëjtë. Sa i përket të hyrave vetanake të këtij tremujori, të hyra pa gjoba të gjykatave në këtë tremujor janë realizuar 209.195, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë 209.007 d.m.th. është mbajtur trendi i njëjtë i të hyrave, por duke llogaritur edhe gjobat e gjykatave të cilat janë marrë pasi është dërguar raporti tek ju, atëherë të hyrat total të këtij tremujori janë 226.195.77, ndërsa në vitin 2018 kanë qenë 221.172.20, kemi një rritje simbolike në krahasim me vitin e kaluar, të hyra në total janë realizuar 21.09% në raport me planifikimin buxhetor për këtë tremujor, janë më pak 4%, por dihet që tremujori i parë i vitit është më i vështirë në kuptim të investimit të hyrave, por besoj që ky trend do të përmirësohet. Sa i përket të hyrave vetanake rritje të të hyrave kemi tek kategoria e të hyrave nga tatimi në pronë, nga taksat administrative, në total nëse i marrim, nga largimi dhe deponimi i automjeteve nga shitja e pasurisë dhe participimet në shëndetësi, ndërsa rënie të të hyrave në krahasim me vitin e kaluar në periudhën e njëjtë kemi tek kategoria e taksave, lejeve të ndërtimit tek taksat për regjistrim të automjeteve, llojet e ndryshme të qirave, tek ajo e tregut, participimet të çerdhet dhe nga gjeodezia, nga participimet e qytetarëve. Këto janë trendet e realizimit të shpenzimeve dhe menaxhimit buxhetit për periudhën janar mars 2019, nëse ka nevojë për ndonjë sqarim shtesë urdhëroni.

Fadil Gashi, falënderoj drejtorin, tha se tash jemi të gjithë anëtarët edhe Xhevxheti erdhi, unë po hapi debat rreth raportit financiar për tremujorin e parë të këtij viti, falënderoj edhe Azizën se nuk e la pa i përmendur edhe laptopët, të cilët i kemi marrë, nëse ka dikush diçka urdhëroni!

Enver Berisha, përshëndeti të gjithë, realisht nuk e kam tendencë me kritikuar dikë, por materiali nuk më ka ardhur i kompletuar. Kam ardhur në Komunë dhe kam marrë një kopje fizike, por kishte disa defekte dhe nuk vërehen mirë shifrat. Kërkoj edhe njëherë nga Shërbimi i Kuvendit të ma dërgojë edhe njëherë në e-mail në mënyrë që të kemi me të qartë dhe pastaj në asamble do t'i japim vërejtjet dhe komentet tona.

Fadil Gashi, tha se ne kemi kërkuar nga ITI-ja që të na themelojë një grup të veçantë për anëtarët e komitetit dhe me sa kam informacion grupi është formuar, sepse konfirmimin e kemi edhe nga ministria që grupi është formuar, prandaj ju kisha lutur që t'i kontrolloni edhe njëherë e-mailet.

Tunë Dedaj, përshëndeti të gjithë të pranishmit, unë e pashë që tek Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë, kemi mungesë të hyrave dhe nuk mund të kemi rritje të hyrave aty përderisa ata gjeodetë, të cilët marrin pagë nga Komuna, me mjetet komunës dalin në terren dhe kryejnë punë private, kjo nuk është aspak në rregull dhe se duhet marrë masa dhe kjo t'ju ndalohej, që brenda orarit dhe jashtë orarit mos t'u lejohen t'i përdorin mjetet e Komunës për çështje private.

Fadil Gashi, tha faleminderit Tunë, edhe unë pajtohem me këtë mendim. Nëse ju keni ndonjë propozim se si të veprohet patjetër se do ta keni edhe përkrahjen time, ne mund edhe ta rekomandojmë për kuvend, tash ata edhe mund të licencohen me ligj si gjeodetë privat, por jo t'i përdorin mjetet e Komunës.

Nëse edhe ju pajtoheni që me të gjitha ato që i tha Tuna dhe i ceka unë, se bashku me Raportin Financiar kush është që të kaloj për Kuvend.

Kryesuesi i vuri në votim.

Me 7 vota PËR u rekomandua për Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë së Fëmijëve në Komunën e Klinës.

Fadil Gashi, tha se sa për njoftim, ne vetëm kemi filluar inicimin e kësaj draft-rregulloreje, më datën 15.04.2019 e kemi mbajtur një takim me publikun dhe të gjitha ato kategori që i prek kjo draft-rregullore. I falënderoj të gjithë ata që kanë marrë pjesë në atë debat. Është një propozim për ndryshim të një neni nga Drejtoria e Arsimit, ku thuhet "Drejtoria Komunale e Arsimit mbështet brenda mundësive buxhetore aktivitetet e ndryshme, festive dhe kulturore të Asamblesë së Fëmijëve në Klinë". Më hollësisht mund ta shihni edhe ju në draft-rregulloren, e cila do të dërgohet në Kuvend me ndryshim. Unë po hapi debat nëse ka dikush diçka rreth kësaj le të urdhërojë!

Enver Berisha, tha se në aspektin juridik dhe administrativ, po e shoh që është i përpunuar mjaft mirë. Ndryshimin, të cilin e kanë kërkuar të bëhet nuk kemi pas mundësi ta shohim, parimisht unë e mbështes, dhe është mirë të aprovohet.

Fadil Gashi, tha se propozimin e ka bërë vetë Drejtoria DKA-ja, sepse organizatat e kanë planifikuar ndryshe që të kenë qasje edhe organizata tjera për financim, por për shkak që të mos ketë keqpërdorime kanë kërkuar definohet, nëse ka dikush diçka rreth kësaj urdhëroni!

Kryesuesi vuri në votim.

Me 6 vota PËR u rekomandua për Kuvend, Shqyrtimi i Draft-rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë së Fëmijëve në Komunën e Klinës.

Pika 5. Shqyrtimi i planit të veprimit për transparencë në komunë për vitin 2019.

Fadil Gashi, tha se është një draft unik për të gjithë, i cili është për katër vite dhe jo për një vit siç ne e kemi cekur, por është një gabim teknik që ka shpëtuar nga ne dhe nga Shërbimi i Kuvendit, sepse për një vit e kemi punuar, por është kthyer, tash duhet ta punojmë planin e veprimit për katër vite, materialin nuk e kemi, por me kusht që të silllet në seancën e ardhshme të Kuvendit ne po e rekomandojmë për Kuvend nëse edhe ju pajtoheni.

Kryesuesi vuri në votim.

Me 5 vota PËR u rekomandua për Kuvend, shqyrtimi Planit të Veprimit për Transparenë në Komunë për katër vitet e ardhshme.

Pika 6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa të arritura për muajin mars-prill 2019.

Fadil Gashi, tha ne kemi disa kërkesa për Komitetin për Politik dhe Financa, unë do t'i lexoj me radhë.

Kërkesë nga Astrit Laci për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër ose afatgjatë, me qira, ngastrën me nr.P-71010020-0 ZK në Dobërdol, lloji i pronës pronë shoqërore kërkon vetëm 3.5 ha.

I nderuari z. Kryesues i Komitetit për Politik dhe Financa, me këtë kërkoj nga organet e juaja kompetente që në bazë të ligjit nr.04/L-144 të datës 22 nëntor 2012 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës se paluajtshme të Komunës ne afat në afat të shkurtër nga 1 deri në 15 vite, dhe në afat të gjatë.

Kryesuesi theksoj, këto ditë ka hyr në fuqi ligji i ri me ndryshime, për dhënie në shfrytëzim të pronës shoqërore, me të cilin parashihet që këto prona të jenë në një listë, dhe të jetë një vlerësim real për secilën parcelë ku komuna mendon që t'i jap në shfrytëzim, ne jemi të hendikepuar që t'i japim në shfrytëzim, sepse kanë ndryshuar procedurat me ligjin e ri, së pari duhet Ekzekutivi ta formojë një listë me ato prona ku mendon që t'i jap në shfrytëzim, pastaj ne duhet ta themelojmë një komision në Kuvend, pastaj të bëhet shpallja publike, të konkurrojnë, pastaj komisioni duhet

t'i vlerësojë dhe prapë komisioni tjetër, i cili duhet formuar për shqyrtimin e ankesave, Ne nuk mund që t'i ndalim qytetarët që mos të sjellin kërkesa, por ne për momentin nuk mund të bëjmë zgjidhje, nëse ju pajtoheni ne po e dërgojmë tek Zyra e Kryetarit, që ata ta formojnë një listë me ato prona, të cilat mendojnë që t'i japin në shfrytëzim, pastaj të veprojmë sipas ligjit, ato të cilat nuk kanë nevojë për këto procedura janë kërkesa nga institucione, fetare, diplomatike, institucionet qendrore, përndryshe tjerat kanë procedura tjera, dy kërkesa janë të kësaj natyre.

Vlen të ceket, një fjali tek kjo kërkesë, ku ka theksuar se unë edhe me parë kam bërë kërkesë Komunës, dhe me datën 20.01.2017 shërbimi profesional juridik ka shqyrtuar kërkesën tonë dhe ka dhen mendimin se kjo pronë, ngastra me nr. 448 mund të jepet në shfrytëzim, me qira pa kurrfarë pengese, por deri me sot nuk kemi kurrfarë përgjigje, dhe shiko deri ku kanë arritur shërbimet tona që pa kurrfarë të drejte t'i përgjigjen kësaj kërkesë, ai e ka një shkresë zyrtare dhe është mirë që të bëhet lëndë për shqyrtim sepse organet tona ja kanë lëshuar këtë, sepse ai i referohet shërbimit profesional juridik.

Enver Berisha, tha se unë në pamundësi që ta shohë kërkesën konkrete, por po e filloj me atë që ju e thatë kryesues, mendoj që palët të cilat adresojnë kërkesa bazohen diku se pse ta bëjmë atë kërkesë në Komunë, por edhe ne duhet që ta kem bazën ligjore, se çfarë përgjigje duhet që t'i japim. Nëse ligji ia mundëson dhe ajo që e tha Tuna, nëse nuk prek interesat direkt të banorëve aty nuk ka diçka të keqe aty që ta shqyrtojmë, sepse ka vendosur dikush më lart se ne që kjo të jetë e punueshme në raste të caktuara, mirëpo po e them duke respektuar gjithmonë ato kritere që në mënyrë që mos të bartim pasoja juridike ne si Komunë. Mirëpo, unë kam një kërkesë konkrete që ju kryesues deri në seancë këtë çështje ta bisedosh me Kryetarin, dhe nëse dakordoheni në seancën që e kemi në funde të muajit, ta themelojmë një komision dhe pastaj ta vazhdojmë punën dhe t'i shqyrtojmë ashtu sipas ligjit, ne nuk duhet që t'i marrim si shqetësim kërkesat të cilat vijnë nga qytetarët, por ne jemi të obliguar që përgjigjet t'ia japim ashtu si na mundëson ligji.

Fadil Gashi, tha nëse ju pajtoheni ne si Komitet, të marrim një vendim në kuptimin e rekomandimit, që për seancë të rekomandojmë themelimin e këtij komisioni dhe ndoshta i paraprijmë asaj iniciative tjetër për formimin e listës me prona të cilat mendohet që të jepen në shfrytëzim, qytetarët kanë drejt të bëjnë kërkesa por ne duhet që sipas ligji ti kthejmë përgjigjen, por për momentin nuk mundem që t'i bëjmë zgjidhje

Nëse ju pajtoheni po e rekomandojmë që në seancën e radhës të themelohet një komision, edhe ashtu tash ligji e kërkon themelimin e komisionit për dhënie në shfrytëzim, dhe kërkesa të dërgohet në Zyrën e Kryetarit.

Kryesuesi Vuri në votim.

Me 7 vota PËR u rekomandua që kërkesa të dërgohet në Zyrën e Kryetarit, u rekomandua që të themelohet komisioni nga ana e kuvendit për shqyrtim dhe dhënie në shfrytëzim të pronës shoqërore.

Kryesuesi Fadil Gashi, theksoi se edhe kërkesa e dytë është e natyrës së njëjtë, është kërkesë nga Besmir Nikqi, i cili kërkon nga Komuna t'i jap një truall për ndërtimin e një shtëpie në fshatin Deiq, tek ura e Haxhis.

Tunë Dedaj, tha se unë po e shoh si shqetësim këto kërkesa, e pashë këtë kërkesë që është bërë që t'i jepet prona në fshatin Deiq, për ndërtim shtëpie, ku banoret s'do të ishin pajtuar në asnjë mënyrë. Unë pajtohem që t'i jepet për ndërtim të ndonjë çerdhe, apo ndonjë ndërtim tjetër ku do të ishte në interes të gjithëve, por jo të shndërrohet në pronë private, është mirë që të pyeten edhe fshataret aty ku bëhet kërkesa, se a pajtohen ata që të jepet ajo pronë a po jo.

Fadil Gashi, Kryesues, tha se pasi që edhe kjo është e natyrës së njëjtë, nëse edhe ju pajtoheni edhe po e adresojmë po ashtu si kërkesën e parë, tek Zyra e Kryetarit dhe pasi që të bëhet themelimi i komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e kërkesave të kësaj natyre.

Kryesuesi vuri në votim.

Me 7 vota PËR KPFR rekomandoj që të dërgohet te Kryetari dhe në seancën e radhës të themelohet një komision në bazë të ligjit, i cili do të merret me vlerësimin dhe dhënien në shfrytëzim të pronës shoqërore.

Kërkesa e tretë, është nga Samie Gjergji, e cila është edhe punonjëse e Komunës tonë, Samija kërkon që brenda mundësive t'i ndihmohet për shkak se kostoja e terapisë është e kushtueshme dhe gjithashtu ka pasur edhe dy operime, se fundi mjekët i kanë rekomanduar që të qëndrojë në një spital për trajtim në Amerikë. Prandaj është e pamundur që të mbulohen të gjitha me mjete vetanake, dhe kërkon nga Komuna që t'i ndihmon me aq sa është e mundur maksimale, unë jam që t'i ndihmohet me të gjitha kapacitetet sa ka mundësi Komuna. Unë po hapi debat nëse ka dikush diçka urdhëroni!

Enver Berisha, realisht ne nuk mund që ta anashkalojmë kërkesën, mirëpo ne Kryesues, e bashkëbiseduam edhe me Kryetarin, ta dimë se a do të mbetet si kërkesë e Kuvendit që shuma të jetë më e madhe apo të jetë në Zyrën e Kryetarit dhe ai ta shqyrtojë dhe me mundësitë sa i lejohet ta ndihmojë për këtë rast.

Fadil Gashi, tha se as në kërkesë nuk e ka cekur se çfarë shume kërkon, por e ka cekur me aq sa është mundësia maksimale, por Kryetari nëse vendosë që ta ndihmoj me shumë sesa i ka limitet atëherë duhet që kërkesën ta adresojë në kuvend.

Violeta Zefi, tha se edhe unë i bashkëngjitëm mendimit tuaj Kryesues dhe të Enveri. Mendoj që patjetër duhet që sa është e mundur ta mbështesim, duke pasqyruar edhe gjendjen shëndetësore të saj.

Tunë Dedaj, tha se unë mendoj se duhet ta mbështesim dhe ta ndihmojmë me aq sa është e mundur kur është në pyetje shërimi dhe shëndeti i saj, duke pasqyruar, sepse është edhe punonjëse e shërbimit në Komunën e Klinës.

Fadil Gashi, tha nëse nuk ka dikush tjetër ndonjë propozim rreth kësaj kërkesë dhe nëse edhe ju pajtoheni rreth asaj se çka biseduam, mund që ta hedhim në votim që ta adresojmë tek Zyra e Kryetarit.

Kryesuesi vuri në votim.

Me 7 vota PËR Komiteti rekomandoi që kërkesa të implementohet nga Kryetari.

Pika e 7: Të ndryshme.

Kryesuesi Fadil Gashi, theksoi se në këtë pikë kemi një kërkesë nga Drejtoria Financave për drejtorin e Arsimit, për transfer të mjeteve nga kategoria e pagave në programin e arsimit, për çdo sqarim me të hollësishëm, e kisha lut drejtorin Aziz Desku që ta marr fjalën, urdhëroni drejtor!

Aziz Desku, përshëndeti të gjithë, theksoj se nga Drejtoria e Arsimit, ka një kërkesë për harmonizim të brendshëm në kategorinë e pagave, nga programi i arsimit të mesëm të merren 6000 euro dhe të transferohen tek arsimi fillorë, dhe 2500 nga arsimi para fillor të merren dhe të transferohen në atë fillor, pra në këto dy programe ku parashihet të bëhet transferi, kanë mungesë të mjeteve dhe ne aty të dyja ku planifikohet të merren ka tepricë të mjeteve. Ju njoftoj se transfere të tilla janë të lejueshme. Në bazë të ligjit për menaxhimin e financave, brenda programeve të të njëjtit program, por edhe brenda programeve të ndryshme kur paraqitet nevoja. Dhe, në bazë të vendimit që do ta marr kuvendi, pastaj ne duhet t'i drejtohem Ministrisë së Financave, që t'i bëjë këto transfere ashtu siç rrjedh vendimi nga Kuvendi komunal,

Enver Berisha, këto mjete që po merren, në kuadër të këtij programi fillor, po shkojnë edhe këto në paga apo po investohen diku tjetër?

Aziz Desku, edhe këto do të transferohen në paga vetëm përmes programit.

Enver Berisha tha se është mos planifikim që ka ndodhë për shkak të rritjes së numrit punëtorëve në arsim apo është mungesë e bartjes së më hershme?

Aziz Desku, me than të drejtën me shumë është mungesë e planifikimit të saktë, të shpenzimeve në kategorinë e pagave. Unë personalisht nuk e kam analizuar, por po paragjykoj se ashtu duhet të jetë, por është transfer i mundur dhe i lejueshëm.

Kryesuesi Fadil Gashi, tha nëse ka dikush diçka rreth kësaj kërkesë urdhëroni, nëse jo po e vë në votim.

Kush është PËR?

Me 7 vota PËR u rekomandua për Kuvend.

Tunë Dedaj, tha se nëse kanë tek pika, Të ndryshme, mendoj që duhet ta ngrehim si shqetësim, i cili po na përsëritet çdo vit. Ne e kemi marrë vendim që të ndahen bursat për studentë, edhe sot e asaj dite nuk janë shpërndarë. Kërkoj që kjo çështje të debatohet në seancën e kuvendit, pse

nuk janë shpërndarë kur buxheti është i ndarë, duke par nevojën që kanë studentet për të vazhduar studimet.

Kryesuesi Fadil Gashi, faleminderit, Tunë! Pas këtij takimi e kam rezervuar një takim me Zyrën Ligjore. Unë personalisht jam marrë bukur thellësisht me këtë çështje. Kam menduar edhe vetë që në takimin me shefat e grupeve, kur ne ta formojmë rëndin e ditës për kuvend, ta vejmë në rend të ditës, sepse ne duhet ta shkarkojmë komisionin që e kemi momentalisht që është për shqyrtimin e ankesave, ata nuk e kanë kryer punën e vet, me rregullore e kanë afatin e përcaktuar me ligj kur duhet ata ta përfundojnë, sepse kjo sjell pasoja sepse as ata të cilët janë shpallur fitues nuk mundë t'i tërheqin mjetet të cilat u takojnë pa përfunduar çështja, me iu thënë të drejtën unë dy apo tri herë kam komunikuar me anëtarët e komisionit, u kam thënë se ne në kuvend ju kemi themeluar që nëse ka shkelje ju duhet që t'i sanoni ato shkelje dhe të merreni me ankesa seriozisht, nuk ju kemi thënë që të shkoni dhe t'i bëni shkeljet e dyta, nëse ka bërë një shkelje komisioni i parë ju mos e bëni të dytën, sepse nuk ju kemi themeluar që t'i shikoni se çfarë emri apo çfarë fotografie kanë studentet, por duhet t'i shikoni ai plotësojnë apo nuk i plotësojnë kriteret, ne nuk ju kemi zgjedhur që të shkoni dhe të interpretoni ligje atje, të gjithë ne e dimë se çka është paga dhe çka është kompensimi, nëse një student ka aplikuar dhe nuk figuron në buxhet si punëtor që merre pagë u krye puna, anëtarët e asamblesë marrin kompensim nuk marrin pagë, kjo përcaktohet me ligj jo me vullnet tonin, edhe s'ka rëndësi prej nga vjen, si e ka emrin, dhe e kujt është apo i kujt është, por neglizhenca është e komisionit për fat të keqe, të gjithë i kemi aty anëtarët, por atij komisioni i ka skaduar afati, nuk kanë mundur apo nuk kanë dashur të bëjnë zgjidhje nuk e di, por edhe ata njerëz që i dërgojmë ne si grupe parlamentare duhet t'i lejmë që të bëjnë zgjidhje dhe jo të ju ndërhyjmë.

Enver Berisha, tha se realisht pajtohem me Tunën, se kjo është një çështje mjaft serioze që do zgjedhje të menjëhershme, por për mua është më shqetësuese, sepse unë isha dje në Zyrën e Kuvendit, sepse shkova të marrë materialin dhe në bisedë e sipër mu dukë shqetësuese trupat që i ka formuar ky Kuvend, që realisht janë jo funksionalë, sidomos komisionet. Unë kam një kërkesë, në rend të parë ashtu siç jemi dakorduar në fillim të këtij mandati, që nëse nuk mund t'i kompensojmë të gjithë anëtarët e Komisionit, të kompensohen të paktën ata që nuk janë në marrëdhënie pune. Unë kam informata që në komuna tjera janë duke u bërë pagesat, nuk e di pse tek ne nuk po mund të arrijmë t'i paguajmë këto komisione? Dhe, nëse këto komisione nuk angazhohen që ta kryejnë punën ne duhet të ndërmarrim masa prapë ne si kuvend, sepse unë mora informatë se ka komision që se di a është takuar krejt njëherë brenda këtij mandati, ne nuk po na vjen asnjë rekomandim në asamble nga këto komisione. Prandaj, t'u kisha lutur që ta bisedoni me Kryetarin edhe me drejtorin e Financave çështjen e pagesave dhe të shikojmë që trupat që ne i formojmë të jenë funksionalë.

Xhevxhet Berisha, përshëndetje Kryesues dhe ju anëtarë, pata një sugjerim për rëndin e ditës në asamble, tek pika, Pyetje dhe përgjigje, a kishte pasur ndonjë mundësi që ta bëjmë, Të ndryshme, që ne të kemi pak më shumë hapësirë dhe kohë pak më tepër që t'i diskutojmë disa çështje që ne na preokupojnë.

Kryesuesi Fadil Gashi, tha se ne të dyja i kemi në rënd të ditës. Çështja të ndryshme , nëse ka dikush ndonjë temë të caktuar, e cila është urgjente ne e vendosim atëherë aty, Të ndryshme, kjo, Pyetje e përgjigje, ne e kemi caktuar afatin vetë, pra kemi vendosë, prandaj po e lëmë kështu siç është.

Nëse ka dikush diçka tjetër për të shtuar urdhëroni, nëse jo, atëherë unë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, me kaq po e përfundoj këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj në orën 11:30.

Procesmbajtësi,
Ahmet Berisha

Berisha

